




REPUBLIKA E KOSOVËS  
KUVENDI I KOMUNËS SË MALISHEVËS



Kuvendi i Komunës  
Nr.02/\_\_\_\_  
Datë: 06.11.2018



PRANUAR ME:  
ACCEPTED ON: 06-11-2018  
PRIMIENO:  
Nr.No.Br. 02/457

PROCESVERBAL

i mbledhjes së III-të ( tretë ) urgjente të Kuvendit Komunal të Malishevës

RENDI I DITËS

1. Shqyrtimi i shkresës së MAPL-së, nr. 020-1138/3, dtaë: 12.10.2018 në lidhje me:
  - a. Rishqyrtimin e vendimit nr.02/382, datë: 02.10.2018
  - b. Rishqyrtimin e vendimit nr. 02/383, datë: 02.10.2018
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Prjekt-Buxhetit të Komunës së Malishevës nr. 04/125, datë: 22.10.2018 për vitin 2019-2021 i propozuar nga Kryetari i Komunës së Malishevës z. Ragip Begaj

Mbledhja mbahet me datë 24.10.2018 dhe filloi në ora 10:30 Të pranishëm në fillim të mbledhjes ishin 28 asamblistë, Kryetari, drejtorët, OSEBE dhe media.

**Rrahim Morina:** Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në sallë! Të nderuar anëtarë të Kuvendit në bashkëpunim me Kryetarin e Komunës kemi thirrur këtë mbledhje urgjente për të nxënë afatin ligjor për projekt-buxhetin që ka Ministria e Financave afatin kohor të caktuar dhe ne duhet ta dorëzojmë këtë buxhet të votuar nga Kuvendi Komunal me kohë.

Ne dje kemi mbajtur një takim të organizuar me kërkesë të Kryetarit ku kemi qenë shefat e grupeve politike, tre drejtorë dhe Kryetari. Ne kemi diskutuar për Projekt-Buxhetin e propozuar nga Kryetari dhe mundësinë e gjetjes të një bashkëpunimi, harminizimi të projekteve dhe kategoritë tjera buxhetore. Ne kemi arritur një kompromis dhe një kopje ju kemi shpërndarë edhe juve të kësaj pajtueshmërie bashkë me ftesën dhe rendin e ditës të kësaj mbledhje.

Në mbledhje urgjente nuk ka debat jashtë rendit të ditës atëherë kush është për rendit të ditës:

Për: unanimitisht (28)

Me këtë votim uanimit është aprovuar rendi i ditës.

Kalojmë në pikën e 1-rë të rendit të ditës: Shqyrtimi i shkresës së MAPL-së, nr. 020-1138/3, dtaë: 12.10.2018 në lidhje me:

a.Rishqyrtimin e vendimit nr.02/382, datë: 02.10.2018

b.Rishqyrtimin e vendimit nr. 02/383, datë: 02.10.2018

E hapi debatin për këtë pikë të gjithë materialin e keni të kompletuar për këtë pikë.

**Alban Mazreku:** Përshendetje për të gjithë! Dje me kërkesën e Kryetarit të Komunës dhe Kryesuesit të Kuvendit shefat e grupeve politike kemi mbajtur një takim. Pas një diskutimi të gjatë dhe pas 3 orësh ne jemi dakorduar që të gjitha kërkesat që janë nga grupet opozitare dhe nga disa asambleistë të NISMA të inkoprohen në buxhetin e propozuar nga Kryetari i Komunës. Ne më vonë me kërkesën e Kryetarit jemi takuar me drejtorin e Financave dhe i kemi paraqitur kërkesat që duhet të inkoprohen në buxhet.

**Rrahim Morina:** Alban, me mirëkuptim e juaj, ajo që po flisni është pika e dytë. Fokusohu në pikën e parë.

**Alban Mazreku:** Kryesuesi i përmendi të gjitha ato procedura që janë shkelur dhe shkresën që është kthyer. Për këtë pikë nuk dua t'a zgjas më tepër diskutimin. Kërkoj falje për ngatërrimin e pikave.

**Alban Krasniqi:** Përshëndetje për të gjithë! Ne e kemi një shkresë nga MAPL-ja e cila është më shumë shkresë politike për sa i përket edhe afateve edhe procedurave, pra është përdorur ndikimi politik për të ardhur deri te ajo shkresë në atë mënyrë sepse MAPL-ja ka mundur të merrë informacione se kur është mbajtur mbledhja dhe si është mbajtur ajo.

Për të mos rrezikuar buxhetin i cili ju dedikohet qytetarëve të komunës dhe kam pranuar që të zbatojmë vendimin e MAPL-së në ato dy çështje që ajo ka dërguar. Mirëpo duhet ta ketë parasysh Kryetari me stafin e vet sepse jam i zhgënjyer thellësisht me nivelin e përgjegjësisë së tyre. Në buxhetin që ka propozuar para dy mbledhjes Kryetari kam vërjetur gabime aq të mëdha sa që për mua nuk ka qenë buxhet ai, por një shakrravinë. Buxheti nuk ka planifikim, nuk ka prioritete, nuk ka kosto mjedisore dhe sociale etj.

Kryetar e ke humbur edhe atë pikë respekti që kam pasur për ty sepse vazhdove përsëri me ato ljera të ulta duke keqpërdorur e gjithë punën që kemi bërë dje me vullnetin më të mirë që të mos humbasim buxhetin. Ti nuk mundesh ta bllokosh buxhetin.



Kërkoj që të shfuqizohen këto dy vendime dhe të vazhdojmë me gjendjen fillestare për miratimin e buxhetit për qytetarët e Malsihevës dhe të vazhdojmë që ta monitorojmë pastaj buxhetin se a po shkon sipas planifikimit.

**Luan Kryeziu:** Përshendetje për të gjithë! Shkeljet që po bëhen këtu së pari bëhen nga ana e Kryesuesit dhe kërkoj që ta respektosh Rregulloren siç atëherë kur kërkojë respektimin saj në numrin e formimit të grupeve dhe çështjen e mituazhës, jo të shkosh në anime të interesave tuaja si Kryesues i Kuvendit.

Kryesues ty po të quaj edhe Kryesues Urgjent sepse çdo mbledhje që jemi duke e mbajtur është urgjente. Vendimi i MAPL-së është ardhur para 15 ditësh dhe këtë mbledhje kemi mundur ta mbajmë të rregulltë respektoje udhëzimin se kur thirret një mbledhje urgjente.

Në vendim thuhet që: refuzohet projekt-buxheti nr.04/106, datë: 14.09.2018 për vitin 2019-2021 i propozuar nga Kryetari i Komunës. Ky buxhet s'ka qenë i propozuar nga Kryetari i Komunës por ai alternativ i dërguar nga ana e juaj. Ka pas shkelje nga Asambleja atë ditë sepse nuk e ka respektuar buxhetin e propozuar nga Kryetari.

Nëse vazhdojmë këtë formë duke ju referuar Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, te neni 50, pika c, thotë: Kuvendi i Komunës konsiderohet jofunksional nëse nuk miarton buxhetin sipas afateve të parapara me ligjin përkatës. Dijeni se jeni duke shkuar drejt zonës së rrezikshme për të shkuar në zgjedhje të Asamblesë si rezultat i këtyre bllokadave, veprimeve të dëmshme në Kuvend.

Te neni 58, pika i, është përgjegjësi e Kryetarit të Komunës çështja e përgatitjes së Projekt-Buxhetit, propozon zhvillim komunal, planet rregullative investuese dhe propozon buxhetin në Kuvend, e ju vetë e keni bërë projekt-buxhetin dhe keni shkel në kompetenca të Kryetarit të Komunës.

**Rrahim Morina:** Luan, pom vjen keq që nuk e paske lexuar nenin 60 hiç edhe pse je jurist! Janë dy vendime, njëri është refuzues projekt-buxheti i propozuar nga Kryetari i Komunës dhe vendimi i dytë që thotë kështu: miratohet buxheti i K. së Malishevës për vitin 2019-2021 i propozuar sipas kërkesës nr. 02/370, datë 28.09.2018 nga anëtarët e Kuvendit nga PDK-ja, LDK-ja dhe VV-ja.

**Avdi Morina:** Përshendetje për të gjithë! Më të vërtetë këtu është krijuar një situatë jo e mirë dhe me vjen keq për këtë!

Pajtohem që shqyrtimi i shkresës së MAPL-së në a dhe b që të votohen dhe të dalim nga koj gjendje e cila është krijuar dhe të votojmë buxhetin qoftë i qeverisë, qoftë edhe i propozar nga opazita. Pothuajse që 90% të projekteve janë të njëjta dhe këto më shumë janë inate të grupeve politike. Kërkoj që bashkarisht të veprojmë dhe të dalim nga kjo çështje dhe buxhetin ta votjmë së bashku.

**Halil Morina:** Përshendetje për të gjithë! Kjo çështja e buxhetit është e rëndësishme sepse kemi bërë përpjekje që të orientojmë parane e taksapaguesëve të kësaj komune. Secili prej nesh këtë çështje është dashur ta shoh prej një këndi objektiv dhe këtë s'kemi mundur ta bëjmë asnjëra palë.



MAPL-ja me këto shkresat veta shpeshherë më shumë shkakton konfuzitet se sa që zgjidh probleme. Kryesuesi ju referua nenit 61 për shkak të shkeljeve procedurale. Shkelja kyçe është pse Kryetari nuk e ka dorëzuar buxhetin më 1 shtator. Kjo është arsyeja pse është refuzuar buxheti. Atëherë si mund të dalim nga kjo situatë?

As një shkelje procedurale nuk i jep të drejtë opozitës sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale që të paraqesë një buxhet alternativ. Aty thuhet që Kryetari e ka për obligim që të hartojë projekt-buxhet dhe Kuvendi e ka për obligim që ta shqyrtojë e të miratojë atë. Sipas shkresës që ka kthyer MAPL-ja nuk po shoh ndonjë zgjithje, thjeshtë duhet të vazhdojmë me pasojat e dështimit të buxhetit.

**Hashim Vreniezi:** Përshendetje për të gjithë! Propozoj që të rishqyrtohen këto dy vendime dhe e kemi të qartë që jemi rikthyer në buxhetin e propozuar nga Kryetari Begaj. E falemnderoj Kryetarin që ka gjetur mundësi që të bashkëpunojë me grupet opozitare dhe që kanë arritur një marrëveshje për korrigjimin e disa gabimeve teknike të cilat i kemi korrigjuar bashkarisht me drejtorin e Financave. Shkelje ligjore nuk ka pasur por shkelje procedurale të cilat mund të ndodhin gjithkund.

**Valon Krasniqi:** Përshendetje për të gjithë! Ne grupi ynë kërkojmë që respektohet koncensuesi dhe uniteti që dje e kemi pasur në takim së bashku.

**Kryetari - Ragip Begaj:** Unë jam munduar që të jem bashkëpunues jo vetëm tani, por gjatë gjithë jetës. Nëse dikush e ka përcjellur mbledhjen e kaluar unë kam qenë shumë i qarët që forma se si ju jeni duke shkuar është e gabueshme dhe kishte shkelje procedurale. Kam kërkuar nga ju që të paraqiteni kërkesat e juaja dhe ti inkorporoni në projekt-buxhetin që kam prezantuar unë. Por e gjithë kjo ka dalur jo mirë sepse ju keni qenë gabim. Ndoshta reagimi im ka qenë i ashpër por është e vetmja K.e Malishevës që ka bërë këto gabime.

Në takimin që kemi pasur dje kemi arritur deri diku t'i harmonizojmë gjërat dhe i kemi përmirësuar ndoshta ato gabime numerike prej një pozicioni. Sikur të lypim hollësisht ky projekt-buxhet i përbashkët është dashur të kalojë përsëri nëpër KPF- për t'i parë ato ndryshime që janë bërë.

Atë ditë mbledhja se si është thirrur urgjente ka qenë shkelje dhe shkelje ka qenë edhe miratimi i buxhetit alternativ. E di që unë e kam vonuar buxhetin, edhe ajo është shkelje por megjithëatë kur MAPL-ja nuk kishte për ta kthyer prapë për shkak të vonesave. Tani mos i adresoni shkeljet e juaja tek unë. Unë edhe atë ditë ju kam treguar që e keni gabim dhe ju kam kujtuar procedurat dhe gjithashtu kamë kërkuar që kërkesat e juaja të harmonizohen në buxhetin që pata propozuar unë. Sikur të më kishit dëgjar atë ditë, besoni që ai buxhet do të kalonte dhe sot nuk do të kishim diskutuar për këtë çështje.

Unë përsëri po kërkojë që këtë buxhet ta finalizojmë së bashku por megjithëatë jeni ju ata që vendosni. Por edhe njëherë faji im nuk është për kthimin e buxhetit, por i juaji.

**Alban Krasniqi:** Fillimisht duhet të ndryshoj qasja prej komunës, Kryetarit, drejtorëve në raport me ne.

Një parafolës i NISMA përmendi këtu që paska informacione që qenkan duke u kryer disa projekte. Pse nuk i kemi ne ato informacione? Deri sa ju nuk jeni në gjendje për të dhënë informacione, sepse s'po ju konvenon dhe deri sa nuk jeni në gjendje të hartoni me kohe buxhetin gjithëmonë kanë për të ndodhur këso problemesh. 1 shtatori duhet të jetë buxheti i



përfunduar i përfshirë edhe nga ne për herat tjera. Ne deri ditën kur ka ardhur këtu buxheti nuk kemi pasur asnjë informacion. Pra ndërrojeni qasjen dhe nuk do të paraqiten këto probleme. Ne jemi përballur dje me shantazh, me lojëra të dyfishta dhe ne nuk jemi për këso lojëra.

**Rrahim Morina:** I kemi dy nënpika të pikës së 1-rë të rendit të ditës, nënpikën a dhe b. Vendimet i keni para vetës atëherë shkojmë në votim.

Kush është Pro për shfuqizimin e vendimit nr.02/382 të datës: 02.10.2018?

Për: unanimitisht (28)

Atëherë me votim unanimit konstatoj që u shfuqizua ky vendim.

Kalojmë në nënpikën b. Për shfuqizimin e vendimit nr. 02/383, datë: 02.10.2018 që ka qenë për buxhetin e miratuar për vitin 2019-2021i propozuar sipas kërkesës me nr. 02/370, datë 28.09.2018 nga anëtarët e Kuvendit nga PDK-ja, LDK-ja dhe VV-ja. Kush është pro shfuqizimit të këtij vendimi?

Për: unanimitisht (28)

Me këtë votim unanimit u shfuqizua edhe ky vendim.

Kalojmë në pikën e 2-të të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt-Buxhetit të Komunës së Malishevës nr. 04/125, datë: 22.10.2018 për vitin 2019-2021 i propozuar nga Kryetari i Komunës së Malishevës z. Ragip Begaj. Kryetar urdhëroni e keni fjalën!

**Kryetari – Ragip Begaj:** Nuk dua të lëshohem në detaje sepse ky projekt-buxhet është trajtuar disa herë. Ne dje jemi takuar dhe kemi diskutuar të gjithë së bashku me shefat e grupeve politike dhe në përgjithësi jemi pajtuar me një buxhet të vetëm. Nuk jamë tërhequr nga ato që kam thënë për zvogëlimin e disa pozicioneve siç është tek bujqësia. Ne jemi regjion bujqësor dhe më së shumti duhet të investohet dhe të përkrahet bujqësia. Është dashur që të kemi më së shumë projekte në bujqësi që janë të nevojshme dhe të domosdoshme në Malishevë. Pra nuk ishte ideja e imja që të zvogëlohet fondi i bujqësisë por të rritet edhe pak sepse ka nevojë të mbështetet ky sektor.

Tek shërbimet shëndetësore i kemi disa pozicione të zvogëluara dhe unë kam qenë kundër saj, bisedoni me ato familje që kanë përfituar shërbime në shtëpi dhe do ta shihnit se sa të nevojshme janë.

Te projekti për Qendren e Banimit Social kontratat janë të bëra dhe puna ka filluar ndërsa ju e leni buxhetin për vitin 2020, për mua kjo është e gabueshme. Ne jse vendosni ju ashtu siç ju merr mendja që është më mirë, por kjo të mos jetë përgjegjësi e imja. Të njëjtën dukuri e kemi edhe te shkolla e Panorcit.

Te bashkëfinancimi i kemi pasur diku 150,000.00€ ju keni zvogëluar dhe i kemi prur shumën deri në 50,000.00€. Sa projekte unë mundem t'i bashkëfinancoj me këtë shumë nuk e di. Prapë kjo le të jetë përgjegjësi e juaja. Por nuk është faji i jem nëse unë s'kam pasur mundësi që të bashkëfinciojë për një projekt të rëndësishëm për K. e Malishevës. Daleni e shikoni a kam diçka personale këtu? Jo! Atëherë e gjithë kjo që kamë kërkuar është në dobi të qytetarëve të K.së Malishevës. Unë do të përpiqem të punoj me nder aq sa më jep mundësi Kuvendi.



**Kastriot Berisha:** Pajtohem edhe unë Kryetar me diskutimin tënd nëse është ashtu, por nuk është. Po ndërlidhem tek bujqësia për zvogëlimin e mjeteve në sektorin e bujqësisë. Kryetar çfarë transparence ka kur ndahen subvencionet në bujqësi, kur përfitojnë individë partiak? Unë si kryesues i Komitetit për Bujqësi shumë herë kam kërkuar listat e aplikuseve dhe të përfituesëve dhe shumë informacione tjera, por asnjëherë s'kam marr përgjigje. Pikërisht ka ra drejtori i Bujqësisë për punën jo transparente që ka bërë dhe ne i kemi ulur mjetet në këtë sektor. Të gjithë jemi për përkrahjen e bujqësisë por duhet të jeni transparentë, nëse edhe këtë fond e keqpërdorni për militantët e partisë për vitin tjetër do të kërkojmë që të zvogëlohet edhe kjo shumë.

**Valon Krasniqi:** Sa i përketë buxhetit dhe puna ekipore i kontribuojnë të gjithë shoqërisë së K. së Malishevës. Dallimi në mes buxhetit që pati propozuar Kryetari dhe këtij sot po shoh disa ndryshime të rëndësishme për të mirën e qytetarëve dhe duhet ta ruajmë unitetin mbledhjes së djeshme. Në këtë buxhet është futur rregullimi i memorialit për Maskarën e Burimit, ndërtimi i qendres për kategoritë e dalura nga lufta e UÇK-së, renovimi dhe funksionalizimi i Muzeut të UÇK-së, vendosja e anshensorit në QKMF, ndërtimi i disa fushave të sportit etj. Mendoj që ky buxhet është mirë i planifikuar dhe duhet të votohet unanimisht.

**Alban Mazreku:** I dëgjova me vëmendje kërkesat e Kryetarit kërkesa që edhe dje i kemi diskutuar. Sa i përketë zvogëlimit të fondit për shëndetësi dhe fondeve për ndërtimin e qendres për banim social dje premtuam në emër të grupit që nëse do të ketë mangu fonde për ndërtimin e kësaj qendre ne do të nxjerrim një vendim si Asamble për një fond të veçantë sa është i nevojshëm pas pranimit teknik t'i ndahen atij objekti. Të njëjtën gjë do ta bëjmë edhe për shkollën e Panorcit.

Unë kërkoj një pauzë prej 10 minutash që t'i harmonizojmë këto gjëra dhe të i inkorporojmë në buxhetin të cilin e ka propozuar Kryetari i Komunës. Drejtori i Financave i ka të gjitha në email për ato që jemi dakorduar dhe së bashku ti inkorporojmë ato.

**Alban Krasniqi:** Faza e hartimit të projekteve dhe të buxhetit në këtë rast mendoj që tani ka përfunduar. Mendoj që propozimet dhe ndryshimet i kemi bërë dje dhe e kemi bërë një punë të mirë. Të dy projektet që u përmenden Qendra për Banim Social dhe shkolla e Panorcit dhe mendoj që kjo shkollë është shpezim i parash publike në mënyrë të pamatur këtë e kam theënë edhe më heret te raporti i Drejtorisë së Arsmi. Ne jemi duke follur për vlerën 100,000.00€ e që është diku 30% e punës dhe me ligj s'ke të drejtë të japësh para para se të bëhet pranimi teknik as të Qendres së Banimit Social e as të shkollës së Panorcit.

Kryetar është jo serioze që të propozosh projekte aty për aty, atë që e përmende për çerdhen në Drenoc e neve projekti nuk na ka ardhur. Ne sot po aprovojmë buxhet për 2019, te fondi për bashkëfinacim ne është dashur cilat fonde dhe subvencione kanë për të ardhur nga jashtë tani është dashur ta dimë sepse ato vinë shumë përpara ma planifikime. Vlerën që është 50,000.00€ nuk është e definuar se për çfarë është vetëm që thuhet për bashkëfinacim, po cilat janë ato bashkëfinacime?



E kuptoj mirësinë e Albanit që të takohemi, por unë nuk e shoh të nevojshëm një takim të tillë sepse e kemi dhënë atë më të mirën për buxhetin gjithëpërfshirës dje.

**Ali Morina:** Përshëndetje për të gjithë! Kryetar me gjithë ato informacione që kam Qendra për Banim Social është e kontraktuar prej operatorit që do t'i kryejë punët në afat 2-vjeçar dhe gati nuk do të bëhet për vitin 2019. Për këtë mendoj që nuk është pengesë fondi që është paraparë për këtë qender.

**Sylë Dukolli:** Është mirë që kërkesat e Kryetarit që kanë qenë të propozuara në atë buxhetin tonë e që nuk kaloi për shkak të numrave e kaloi një tjetër të zënë vend edhe në këtë buxhet.

Në emër të grupit pajtohemi që të takohemi në nivel të shefave të grupeve dhe gjitha ato kërkesa të mundshme që mund të futen në këtë projekt-buxhet veç sa ja shtojnë velerën atij.

Nëse Kastrioti ka diçka me drejtorin e Bujqësisë nuk çështje që duhet të ndikojë që të ulen investimet në bujqësi sepse në fshatin tim nuk është ndarë asnjë subvencion në emër të militantizmit, këtë e them me përgjegjësi të plotë.

Besoj që këtë buxhet Kryetari do ta zbatojë në pikëmëri.

**Kryetari – Ragip Begaj:** Me Ministrinë e Infrastrukturës e kam një marrëveshje për bashkëfinacim për rrugën në Rud-Dushkë, ata 400,000.00€ ne 40,000.00€. Me bashkëfinacim ka rrugë te lagjia“ Hoti”, Kërvasari, Banjë etj.

Mendoj që ma mirë është t'i ikim ndriçimeve publike e në vend të tyre të investojmë në kanalizime sepse aty jemi keq dhe pa buxhet nuk mun t'i përmirësoj ato.

Kam menduar që më e nevojshme është edhe një çerdhe në Malishevë se sa në Kjevë, sepse shumica e grave të punuësuar janë në Malishevë.

Po ju garantoj që fondet në bujqësi nuk janë keqpërdorur por ka përfitues të qytetarëve nga të gjitha subjektet politike dhe ju këtë e dini mirë. Pra hiqeni dyshimet.

Alban, nuk ka asnjë objekt që lëshuar pa pranim teknik. A është bërë pranimi keq a mirë unë s'jam ekspertë i kësaj, por njerzit profesionistë e kanë bërë pranimin teknik.

**Avdi Morina:** Unë i kam tri kërkesa që mund të diskutohene që mëndoj që janë me prioritet.

1. në kuadër të këtij projekt-buxheti është mirë që ta ruajmë një koncesiuës edhe për të ardhmen dhe mos të përdorim fuqinë e votës dhe të përfshihen kërkesat e Kryetarit
2. të eliminohen disa gabime teknike të cilat kanë mundur të rrejdhin siç ka raste kur një rrugë është në fazën e punimeve dhe përmendet për vitin tjetër
3. të largohen disa projekte që realisht nuk janë prioritare siç është rasti rregullimi i parqeve gjelbëruese nëpër fshatra si në Tërpezë, Gurbardh dhe Marali. Nuk e di ku ka vend më gjelbërues se sa Tërpeza?! Po e them këtë sepse në disa fshatra akoma s'ka rrjet të ujërave të zeza e që është më me prioritet se sa parqet.

Pra, është mirë që të kordinohemi në ato pika ku është më i nevojshëm bashkëpunimi dhe unanimitisht ta votojmë buxhetin.



**Rrahim Morina:** Atëherë shkojmë në pauzë për 10 minuta.

Pas kësaj pauze më në fund konsideroj që arritëm një koncension do të bëhet bartja e mjeteve nga nxemja qendrore e objektit të ri të komunës për çerdhën në Malishevë dhe vlera e saj është 30,000.00€. Udhëro pra Hashim!

**Hashim Vrenezi:** Unë dua vetëm të sigurohem që asamblestët e kanë verzionin e buxhetit të ndryshuar në bashkëpunim me gjitha partitë këtu dhe duhet të dijnë qytetarët se cilat ndryshime janë bërë. Ne bëjmë thirrje që të votohet buxheti me ndryshime të propozuara nga ana e jonë.

- Bashkëfinancim me qytetarët në projektet e infrastrukturës publike janë 50,000.00€
- financimi i fermerëve me farë dhe plehëra të cilët nuk hynë në kategorinë e subvencioneve nga qeveria e që i bie më pak se dy hektarë janë 50,000.00€
- financimi i fermerëve në ngritjen e serave, vlera 40,000.00€
- financimi i fermerëve në ngritjen e pemishteve, vlera 40,000.00€
- financimi i fermerëve në konsolidimin e fermave bletoriale, vlera 40,000.00€
- suvencionimi i ndërmarrjeve prodhuese bujqësore, vlera 50,000.00€
- financimi i fermerëve me mekanizma nujqësor, paisje, vlera 20,000.00€
- financimi i fermerëve me makineri bujqësore, vlera 60,000.00€

Infrastruktura rrugore në Malishevë në total buxheti është 462,000.00€

- kanalizime, vlera 230,000.00€. Kanalizimet janë të specifikuara me emra të fshatrave, me rrugë dhe me metër.
- Ujësjiellësi, Bellenicë, Temeqinë, Panorc, Rud, Llapçevë në vlerë 120,000.00€
- Ndriçimi publik, vlera 70,000.00€ ku janë të specifikuara emrat e fshatrave, rrugët, trupat ndriçues
- Mirëmbajtja e rrugëve lokale, vlera 50,000.00€
- Rregullimi i varrezave të martirëve në Gurbardh 22,000.00€
- Automjet sulmues për zjarrëfikës 80,000.00€
- Ndërtimi i rrugës nga ura kryesore deri te ura e minitransitit në dy anët me vlerë 250,000.00€
- Trotuarët me vlerë 300,000.00€ ku janë të specifikuara emrat e fshatrave, rrugët, metrat e gjatësisë
- Ndërtimi i rrugëve me kubëza 130,000.00€ ku janë të specifikuara emrat e fshatrave, rrugët, metrat
- Asfaltimi i rrugëve 660,000.00€ ku janë të specifikuara emrat e fshatrave, rrugët, metrat
- Renovimi i objektit të komunës 50,000.00€
- Instalimi i nxjemjes qendrore në objektin e ri 30,000.00€ që këtë vlerë me marrëveshjen tonë të shkojë për çerdhën në Malishevë
- Rregullimi i parkut të qytetit në Malishevë 15,000.00€
- Rregullimi i parkut në Gurbardhë 10,000.00€
- Ndërtimi i prakut në Marali te labidari "Ruzhdi Gjyliqi" 30,000.00€



- Ndërtimi i parkut të gjelbër në Tërpezë, 10,000.00€
- Renovimi dhe mirëmbajtja e labidarëve të dëshmorëve 40,000.00€
- Rregullim i vendodhjes së Masakres së Burimit, 18,000.00€
- Ndërtimi i qenders për kategoritë e dalura nga lufta e UÇK-së 50,000.00€
- Instalimi i nxjemjes qenderore në Muzeun e Qytetit 20,000.00€
- Renovimi dhe funksionalizimi i Muzeut të Dëshmorëve të UÇK-së, 20,000.00€
- Renovimi i palstërs sportive “Habib Zogaj”, 15,000.00€

#### Shërbime shëndetësore primare

- Ndërtimi i objektit të Emergjencës, 100,000.00€
- Renovimi i QKMF-së, 52,000.00€
- Vendosja e anshesorit në QKMF, 20,000.00€
- Autobulancë QKF Kjeve, 20,000.00€
- Përkujdesje shëndetësore për familjet për nevojat e fëmijëve të posalindur, 130,000.00€
- Spërkatja e rriqërave, 60,000.00€
- Instalimi i nxjemjes qendrore në QKF në Kjeve, 12,000.00€
- Aparati dixhital për caktimin e termineve të pacientëve, 10,000.00€
- Autobulancë në QKMF, 40,000.00€
- Ultrazëri për Repartin e Gjinokologjisë, 20,000.00€
- Aparati i mamografisë, 22,000.00€

#### Renovimi i objekteve shkollore 150,000.00€

- Invertar për shkolla, 53,551.00€
- Kabinete shkollore janë të specifikuara emrat e shkollave janë 80,000.00€
- Rregullimi i oborrit të shkollës “Ibrahim Mazreku”, 10,000.00€
- Rregullimi i oborrit të shkollave Mleqan, Gullubovc, Mirushë, 40,000.00€
- Ndërtimi i 6 fushave sportive, 150,000.00€, janë të cekura ku.
- Ndërtimi i çerdhës në Kjeve, 100,000.00€
- Janë grandet për shkolla ku janë të specifikuara
- Ndërtimi i shkollës fillore në Gurbardh, 170,000.00€
- Ndërtimi i palestrës sportive në Astrazub,
- Ndërtimi i shkollës në Panorc, 100,000.00€

Këto janë të gjitha.

**Avdi Morina:** Kryesues nuk je profesional hiç. Ne arritëm koncesiuës dhe ti hape debat. Ne u morëm vesh që vetëm ndryshimet të përmenden që ndodhën në buxhet. Në qoftës është dikush që duhet ta prezantojë buxhetin, atëherë i takon drejtorit të Financave. Ne u koordinuam që vetëm ndryshimet të përmenden dhe të votohet buxheti.

**Alban Krasniqi:** Hashim po të plotësoj. Te kabinetet për shkolla të shkencave natyrore në shkollën “Ibrahim Mazreku” në Malishvë, “Sali Bytyçi” në Shkozë, “Imer Krasniqi” në Carrallukë, “Ganimete Terbeshi” në Astrazup, “Isamil Qemali” në Bellanicë, “Afrim Buçaj” në



Lladroc, "Petro Nini Luarasi" në Llapçevë, "Lazgush Poradeci" në Kjevë dhe shkolla "17 Shurti" në Banjë.

Ndërtimi i 6 fushave të sportit është në shkollat fillore në "Imer Krasniqi" në Carrallukë, në Gullbovc, Lladroc dhe Shkozë.

Të projekt-buxheti për shëndetësi këto janë ndryshimet që janë bërë:

- shërbime të ndryshme shëndetsore tani janë të parapara 54,000.00€
- mirëmbajtja e automjeteve janë hequr nga 40,000.00€, janë bërë 20,000.00€, ndërsa shuma tjetër janë bartur tek paisje tjera mjeksore, mamografi etj.

Te pjesa e buxhetit të komunës, mallëra dhe shërbime janë bërë ndryshimet:

- pagesa për komitetet joobligative 20,000.00€

Te shërbime tjera kontraktuese, 40,000.00€ janë ndarë për hartën zonale. Ky është një fillim i mirë për të bërë hartën zonale.

Te paisjet tjera ndryshimet janë:

- inventar për Zyren e Kryesuesit, stafit dhe paisje të Sallës së Kvendit me zërim janë ndarë 10,000.00€
- paisjet e teknologjisë për Qendren për Punë Sociale në Malishevë, janë 5,000.00€

Te arsimit me kërkesë të drejtorit, te pjesa e shpenzimeve jashtë vendit janë ndarë 12,000.00€ për vizitë të mësimdhënësve pensionistë në Mësojntoren Shqipe në Korçë.

**Kastriot Berisha:** Kryesues, kam vërejtje edhe për Hashimin edhe për Albanin sepse ne së bashku u dakorduam që të vijmë të shkruara dhe ta votojmë këtë buxhet me gjithë ndryshimet që u bënë. Nuk ishte e nevojshme gjithë ky lexim, sepse ishim pjesë e kësaj dhe e dinim këtë. Kryesues, ndërpreje debatin dhe hedhe në votim debatin, ashtu u morëm vesh.

**Arbëreshë Krasniqi:** Kryesues, mbase e hape debatin tash mundesoja të gjithëve diskutimin sepse ne do t'i shfrytëzojmë mundësitë tona.

Ne arritëm një koncesion me gjithë ato vëretje që kishim, me gjithë këtë situatë që pikërisht opozita e prur me buxhete alternative. Këto janë veprime qesharake të juajat sepse keni qenë të sigurtë që do ta pranojë MAPL-ja. Po genjëheni nga njerëzit e që po tentojnë mashtrueshëm të bëjnë politika këtu. Ne këto nuk do t'i lejojmë. Kryesues po keqpërdorën ulësen tuaj dhe ke ra pre e njerëzve të cilët të kanë ul aty. Është keqpërdorim i politikave të mbrapshta që po tentoni t'i jepni kahje negative edhe vet implementimit të votimit të buxhetit në Kuvendin Komunal. Kjo për ne është e papranueshme!

Ne si grup do të votojmë sot për të gjitha projektet që do të shkojnë te qyteatrët e Komunës së Malishevës. Këtu s'ka ndasi, s'ka politikë dhe ky buxhet do t'i prekë të gjithë qytetarët pa dallim. NISMA dhe qeveria Begaj ka dëshmuar fuqishëm që ne nuk çojmë projekte ku ka votues NISMA por çojmë projekte në të gjithë Komunën e Malishevës sepse fatbardhësisht në gjithë K. e Malishevës kemi votues.



Po ju jap një informacion të gjithë juve këtu dhe qytetarëve janë 20,000,000.00€ investime që po vinë në Malishevë. Ne do të votojmë pro buxhetit dhe gjithë qytetarëve ju uroj që ta gëzojnë këtë buxhet!

**Luan Kryeziu:** Kryesues, kur të jemi tek pika e rendit të ditës fillimisht duhet të hapësh debat e pastaj të votohet. Ne e kemi të drejtën e fjalës për diskutim dhe është e përcaktuar me Rregullore, atëherë respektojeni.

E falemnderoj Kryetarin dhe gjë ekzekutivin për këtë buxhet por i vërejtja që disa projekte që janë propozuar nga ana e opozitës për vitin 2019 e di që janë duke u realizuar në vitin 2018. Kjo lë të kuptojmë që kur veprojmë pa bashkëpunim me drejtoritë, mundet të dalësh me projekte të cilat janë duke u realizuar. Shëmbull konkret është rruga në lagjen “Bardhlokaj” në Pagarushë është i paraparë 300m për vitin 2019 por ai projekt është duke u realizuar tani e ajo rrugë është 700m. Kjo duhet të ndryshohet në buxhet dhe të shkojë me një rrugë tjetër në Pagarushë dhe propozoj që të shtrohet rruga “Dielli” në lagjen e “Dukojve”.

Këtu vura re që disave po ju pengojnë investimet nga qeveria qendrore pikërisht te mangësitë buxhetore që keni tentuar që t’i largoni psh. një pjesë e mjeteve është larguar nga ana e opozitës për Qendren e Banimit Social. Kush është ai njeri prej partive tjera që ka sjellë investime në Malishevë se sa Fatmir Limaj? Pra, është mirë që mos të krijoni urrejtje për nejerëzit që punojnë për Komunën e Malishevës!

**Halil Morina:** Kryesues para se të hedhësh diçka për votim duhet njëherë ta verifikosh se a është shetrrur debati apo jo.

Më vjen mirë që më në fund u dakorduat për projekt-buxhetin! Por, unë kam disa vërjetje serioze për buxhetin. Ky projekt-buxhet që u dakorduat së bashku i ka disa probleme që i prekin direkt qytetarët e Malishevës si te zvogëlimi i buxhetit në disa sektorë. Në sektorin e bujqësisë kemi zvogëlim aty ku preket direkt qytetari, zvogëlim të buxhetit në shëndetësi, pramendo e heqim shumë prej shëndetësisë dhe e çojmë në parqe. Ky zvogëlim i buxhetit në këta sektor është i palogjikshëm dhe i paarsyeshëm pavarësisht asaj që cekën disa nga parafolësit.

**Kryetari – Ragip Begaj:** Të gjithë pajtoheni që ky buxhet është i hartuar nga Drejtoria e Finacave dhe i propozuar nga unë dhe i harmonizuar nga të gjithë ju. Fatmirësisht të gjitha fshatrat janë të përfshira në këtë buxhet dhe e gëzofshin këtë buxhet qytetarët e Komunës së Malishevës! Do të përpiqem që në pikëmeri të zbatohet duke bërë përpjekje të fitojmë edhe të hyra tjera nga financimet e jashtme. Sikur të më kishit dëgjuar edhe herën e kaluar do të ishte miratuar buxheti në këtë formë, por nuk po lëshohem në ato çështje që kanë kaluar. Ky buxhet është meritë e gjithë juve dhe meritë e imja do të jetë për implementim të suksesshëm dhe të ndershëm në favor të qytetarëve!

**Rrahim Morina:** Unë i falemnderoj edhe opozitën edhe pozitën për bashkëpunimin dhe harmonizimin e këtij buxheti për qytetarët e Komunës së Malishevës! Përgatituni për votim.



Është projekt-buxheti për vitin fiskal 2019-2021 i propozuar nga Kryetari i Komunës dhe të njëjtën kohë të gjitha ndryshimet që janë propozuar dhe janë dakorduar pozita dhe opozita inkorporohen në këtë dhe ky buxhet votohet si marrëveshje me ndryshimet që i përmendëm. Pra, kush është Për:


Për: unanimit (29)

Me këtë votim unanimit aprovohet Projekt-Buxheti i Komunës së Malishevës.

Falemnderit të gjithë për pjesëmarrjen dhe me këtë mbledhjen e shpalli të mbyllur.

Mbledhja përfundoi në ora 14:00.

Procesmbajtësja:  
Samire Krasniqi



Kryesuesi i Kuvendit:  
Rrahim Morina

